



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar

Numër 5

S H K U R T 2 0 2 1

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin

Numër 5

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar	7
Përmbledhja e rezultateve	7
Kutia 1. Metodologjia	10
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe kërkesën për kredi	11
Kreditë ndaj ndërmarrjeve	11
Standardet kreditore	11
Kushtet dhe rregullat.....	12
Kërkesa për kredi.....	12
Kreditë ndaj ekonomive familjare	14
Standardet kreditore	14
Kushtet dhe rregullat.....	15
Kërkesa për kredi.....	15
Financimi	16
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara: Ndikimet e Covid-19 në sektorin bankar	17
Pritjet për Inflacionin	19
Metodologjia	19
Përmbledhja e rezultateve	19

Anketa e Kreditimit Bankar

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2020, dhe pritjet e bankave për dinamikën në kreditim për tremujorin e katërt të vitit 2020.

Përveç pyetjeve standarde, në këtë anketë u shtuan edhe disa pyetje mbi ndikimin e pandemisë dhe krizës së nxitur shëndetësore dhe ekonomike mbi ofertën kreditore të sektorit bankar në vend, rrezikun kryesor të perceptuar nga bankat, si dhe ndikimit që kishin skemat lehtësuese të ndërmarra për menaxhimin e krizës pandemike.

Përmbledhja e rezultateve

Oferta kreditore është lehtësuar dhe kërkesa për kredi ka shënuar rritje deri në një masë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020. Bankat i'a atribuan këto dinamika lehtësimit deri në një masë të masave kufizuese të qeverisë në vend dhe qeverive në vendet ku është koncentruar më shumë diaspora kosovare, faktor këta që u reflektuan në rritje të kërkesës së përgjithshme në vend. Përderisa pasiguritë rreth gjendjes pandemike dhe për pasojë, krizës ekonomike dhe sociale vazhduan të mbesin të larta, pritjet e bankave, kryesisht duke u mbështetur në përmirësimin e prospekteve në kontekst të zbulimit të vaksinës dhe mos-shtrëngimit të serishëm të masave nga qeveria, sugjerojnë për ofertë të përmirësuar kreditore. Kërkesa për kredi pritjet të mbetet e pandryshuar në tremujorin e katërt të vitit 2020.

Edhe pse ritmi i rritjes së stokut të kredive për ndërmarrjet u ngadalësua deri në tremujorin e tretë të vitit 2020, kreditë e reja gjatë tremujorit të tretë krahas periudhës së njëjtë të vitit të kaluar u rritën dukshëm, të ndikuar pozitivisht si nga ana e ofertës kreditore, ashtu edhe nga kërkesa për kredi. Gjithashtu, pritjet e bankave për tremujorin vijues vazhdojnë të jenë optimiste. Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë lehtësuar deri në një masë standardet e aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi gjatë tremujorit të tretë 2020. Standardet kreditore kryesisht u lehtësuan për NVM-të, përderisa për ndërmarrjet e mëdha kishte lehtësim marginal. Oferta më e favorshme e bankave kundrejt kreditimit të ndërmarrjeve i'u atribuua kryesisht lehtësimit të masave kufizuese të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, faktor që vlerësohet të ketë ndikuar në rikuperim deri në një masë të kërkesës së përgjithshme në vend. Faktorët që ndikuan pozitivisht ofertën kryesisht ishin mbështetja e kredive nga FKGK dhe qasja e favorshme në financim e bankave. Me gjithë lehtësimin e standardeve kreditore, rënia e tolerancës së sektorit ndaj rrezikut, rritja e rrezikut kreditor në vend dhe jashtë tij, si dhe në një masë më të vogël rreziku i perceptuar nga kolaterali i kërkuar u listuan nga bankat si faktor që ndikuan negativisht ofertën kreditore.

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1

Për tremujorin e katërt të vitit 2020 bankat kanë deklaruar të presin lehtësim të mëtejshëm të standardeve kreditore, me ofertë më të favorshme për NVM-të. Pritjet e bankave bazohen në prospektet më pozitive për rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik në vend si rezultat i lehtësimit të masave kufizuese të ndërmarra për menaxhimin e krizës pandemike, si dhe mbështetjen e FKGK-së. Kontribut pozitiv pritet të ketë qasja stabile e sektorit bankar në financim nga tregu i brendshëm, më saktësisht nga depozitat. Sa i përket maturitetit, bankat pritet të ofrojnë standarde kreditore të lehtësuara veçanërisht për kreditë afatgjata.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u shtrënguan deri në një masë në këtë periudhë, kryesisht përmes zvogëlimit të madhësisë së kredive dhe shkurtimit të afatit të maturitetit. Faktorët që përcaktuan shtrëngimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit ishin rritja e rrezikut të perceptuar përmes riskut nga kolaterali i kërkuar, si dhe rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut - në një nivel më të ulët. Në anën tjetër, faktorët që ndikuan në lehtësimin marginal të kushteve dhe rregullave të aplikuara në kredi ishin kryesisht qasja e favorshme në financim në tregun e brendshëm dhe të jashtëm përmes bankave amë, lehtësimi i masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe mbështetja e ndërmarrjeve në kreditim nga FKGK. Për tremujorin e katërt të vitit 2020, bankat pritet të aplikojnë ofertë kreditore të lehtësuara deri në një masë për ndërmarrjet, bazuar në përgjigjet për kushtet dhe rregullat për kreditë e reja. Konkretisht, bankat deklaruan të presin rritje të madhësisë së kredive për të dy kategoritë e ndërmarrjeve.

Gjatë tremujorit të tretë, kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare rezultoi të jetë rritur dukshëm krahasuar me tremujorin paraprak, duke tejkaluar edhe pritjet e deklaruara në anketën paraprake. Kërkesa e rritur për kredi rezultoi të jetë ndikuar kryesisht nga segmenti i NVM-ve. Në kuadër të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, bankat deklaruan rritje të kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, rritje deri në një masë të kërkesave për financimin e blerjes/bashkimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve, si dhe kërkesës për ristrukturim të borxheve. Në TM4 2020, bankat kanë pritur që me shfaqjen potenciale të valës së dytë të infektiveve në vend, mund të rikthehen masa parandaluese për përhapjen e virusit Covid-19, megjithëse jo në nivelin e masave të aplikuara në tremujorin e dytë të 2020. Rrjedhimisht, bankat deklaruan se nuk presin ndryshime të mëdha në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet. Faktor pozitiv në kërkesën për kredi pritet të jetë nevoja për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, përderisa kërkesa për ristrukturimin e borxhit pritet të ndikojë negativisht kërkesën për kredi nga ndërmarrjet, marrë parasysh që afati për aplikim për ristrukturim të borxhit si pasojë e Covid-19 përfundoi në TM3 2020.

Dinamikat e aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese u ndikuan pozitivisht si nga oferta kreditore ashtu edhe nga kërkesa për kredi, ku kreditë e reja u rritën dukshëm në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare, sipas anketës, rezultojnë të jenë lehtësuara duke marrë parasysh që masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19 u lehtësuan gjatë këtij tremujori. Edhe pse institucionet e vendit kanë ndërmarr masa lehtësuese për menaxhimin e krizës pandemike, mundësia për rivendosjen deri në një masë të masave kufizuese gjatë tremujorit vijues rezultoi në pritje të bankave për lehtësim të standardeve kreditore mirëpo në një nivel më të ulët krahasuar me këtë tremujor.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për segmentin e ekonomive familjare u lehtësuan deri në një masë. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave ishte më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Kryesisht, kushtet dhe rregullat u lehtësuan përmes uljes së normës së interesit, uljes së ngarkesave tjera përveç interesit, si dhe uljes së kërkesës për kolateral. Për kreditë konsumuese bankat gjithashtu rritën shumën e kredive. Faktorët kyç që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 ishin kryesisht rritja e presioneve të konkurrencës, financimi stabil i sektorit nga burimet e

brendshme, lehtësimi i masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, si dhe perspektiva e mirë në tregun e patundshmërive. Për tremujorin e katërt të vitit 2020, bankat deklaruan se presin që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të lehtësohen. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Këto pritje u bazuan në perspektivën e mirë të tregut të patundshmërive, qasje të favorshme të bankave amë në financim, rritjen e presioneve të konkurrencës, financimin stabil të sektorit, si dhe perspektivën më të mirë të bankave amë.

Lehtësimi i masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, dërgesat dhe vizitat e diasporës në vend, si dhe ringjallja deri në një masë e aktivitetit ekonomik u reflektuan në rritje të theksuar të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare në tremujorin e tretë të vitit 2020. Në këtë tremujor, bankat raportuan për rritje të ngjashme të kërkesës për kredi për të dy kategoritë e kredive të ekonomive familjare. Tetë nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi. Bankat raportuan se kjo rritje u ndikua pozitivisht nga të gjithë faktorët e listuar në anketë, mirëpo faktori me ndikimin më të lartë ishte nevoja për ristrukturim të borxhit, pasuar nga perspektiva e favorshme e tregut të patundshmërive. Në tremujorin e katërt të vitit 2020, bankat presin rritje të kërkesës për kredi për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare mirëpo në nivel dukshëm më të ulët se sa në tremujorin aktual. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuuan këto pritje tregut të favorshëm të patundshmërive, si dhe në masë të vogël rritjes së kërkesës për ristrukturim të borxhit.

Pasiguritë rreth prospekteve ekonomike përgjatë vitit 2020, si pasojë e krizës shëndetësore dhe aktiviteteve biznesore të kufizuara rezultuan në rritje të rrezikut kreditor dhe pritje për rritje të mëtutjeshme në vitin e ardhshëm. Përkundër lehtësimit të masave kufizuese dhe rikthimit të aktivitetit ekonomik të subjekteve ekonomike, si dhe masave lehtësuese të ndërmarra nga BQK për mbështetjen e tyre në tejkalimin e krizës, bankat deklaruan rritje të raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive në tremujorin e tretë të 2020. Sipas pritjeve të deklaruara nga bankat, ky indikator pritet të përkeqësohet tutje në tremujorin vijues përkundër programeve mbështetëse për rimëkëmbjen e ekonomisë në vend.

Rezultatet e anketës tregojnë që financimi i bankave gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 u ndikua pozitivisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve, përderisa burimet tjera të financimit nuk patën ndryshime të rëndësishme. Për dallim nga anketa e kaluar, rezultatet tregojnë që financimi i bankave u rrit në një nivel më të lartë nga depozitat e ndërmarrjeve se sa nga depozitat e ekonomive familjare. Gjatë tremujorit të ardhshëm, bankat presin që rritja në qasjen në financim të vazhdojë. Financimi përmes depozitave të ndërmarrjeve pritet të rritet në një nivel më të lartë krahas depozitave të ekonomive familjare. Njëkohësisht, dy banka me rëndësi sistematike presin gjithashtu mbështetje në financim të aktivitetit bankar nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në format e standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore në eurozonë dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën kreditore, ndryshimet në kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjes në financim të sektorit bankar. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe ndryshimeve të pritura gjatë tre muajve të ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohe më të gjatë. Në anketim marrin pjesë nëntë nga dhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithësej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithësej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimit apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit.

Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej - 0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim / rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithësej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

Pyetësi, si dhe seria kohore e rezultateve të AKB, janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020, standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi u lehtësuan, megjithëse me indeks pozitiv të ulët prej 0.08 (indeks negativ prej 0.64 në TM2 2020). Në anketën e kaluar (TM2 2020), bankat kishin deklaruar pritje të përafërta për standardet kreditore për TM3 2020 (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan indeks pozitiv prej 0.14 për ndryshimet në standardet kreditore për NVM-të, dhe indeks pozitiv marginal prej 0.09 për ndërmarrjet e mëdha. Në këtë lehtësim ndikuan përgjigjet e dy bankave me rëndësi sistemike, të cilat lehtësuan standardet kreditore deri në një masë për të dy kategoritë e ndërmarrjeve.

Rol kryesor në lehtësimin e standardeve kreditore të aplikuara nga bankat në TM3 2020 rezulton të kenë luajtur mbështetja nga FKGK, dhe qasja e favorshme në financim e bankave. Me gjithë deklaratat e bankave për lehtësim të standardeve kreditore, bankat listuan edhe disa faktorë që ndikuan negativisht në standardet kreditore si rënia e tolerancës së sektorit ndaj rrezikut, rritja e rrezikut kreditor në vend dhe jashtë tij, si dhe në një masë më të vogël, rreziku i rritur nga kolaterali i kërkuar. Në linjë me ofertën e lehtësuar, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet shënoi rritje të dukshme në këtë periudhë, e veçanërisht për NVM-të.

Bankat pritet t'i lehtësojnë edhe më tutje standardet kreditore gjatë TM4 2020, duke u bazuar në pritjet për fillimin e rimëkëmbjes së ekonomisë në vend. Bankat, saktësisht gjashtë prej bankave pjesëmarrëse, presin që mbështetja e FKGK-së për NVM-të do të ndikojë në lehtësim të standardeve. Gjithashtu, kontribut pozitiv pritet të ketë edhe qasja e sektorit bankar në financim nga tregu i brendshëm, më saktësisht nga depozitat. Njëra prej bankave me rëndësi sistemike po ashtu deklaroi se pret kontribut pozitiv deri në një masë në standardet kreditore nga rritja e presioneve të konkurrencës.


Konkretisht, bankat me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej kreditimin deklaruan të presin mos-ndryshim të standardeve kreditore, përderisa bankat tjera presin kryesisht lehtësim deri në një masë (përgjithësisht një indeks pozitiv mirëpo i ulët prej 0.16). Për NVM-të pritet lehtësim më i lartë i standardeve kreditore krahas atyre për ndërmarrjet e mëdha. Njëkohësisht, sa i përket maturitetit bankat pritet të ofrojnë standarde kreditore të lehtësuara për të dy afatet e maturimit, mirëpo për kreditë afatgjata në një nivel më të lartë (indeks pozitiv prej 0.11).

Në linjë me pritjet për standardet kreditore, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet pritet të ketë rritje deri në një masë, saktësisht për NVM-të me një indeks pozitiv prej 0.19, ndërsa për ndërmarrjet e mëdha me një indeks pozitiv më të ulët prej 0.10.

Kushtet dhe rregullat

Në TM3 2020, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u shtrënguan deri në një masë (grafiku 2). Konkretisht, për NVM-të, shtrëngim deri në një masë kishte në madhësinë e kredive të aprovuara (indeks negativ prej 0.15). Në anën tjetër, normat e interesit ishin segmenti i vetëm me lehtësim edhe pse të ulët (indeks pozitiv prej 0.09). Kushtet dhe rregullat për kreditë e ndërmarrjeve të mëdha po ashtu u shtrënguan në një nivel të ngjashëm, përmes zvogëlimit deri në një masë të madhësisë së kredive (indeks negativ prej 0.15), dhe shkurtimit të afatit të maturitetit (indeks negativ prej 0.12).

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Faktorët që ndikuan deri në një masë në shtrëngimin e kushteve dhe rregullave ishin rritja e rrezikut të perceptuar që ndërlidhet me kolateralin e kërkuar (deklaruar nga një bankë), si dhe rritjes së ndjeshmërisë ndaj rrezikut. Në anën tjetër, faktorët që ndikuan në lehtësimin marginal të kushteve dhe rregullave ishin kryesisht qasja e favorshme në financim në tregun e brendshëm dhe të jashtëm përmes bankave amë, lehtësimi i masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe mbështetja e ndërmarrjeve në kreditim nga FKGK.

Duke u mbështetur në prospektet pozitive sa i përket fillimit të procesit të rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik në vend, për TM4 2020, bankat presin lehtësim të kushteve dhe rregullave të kreditimit deri në një masë. Bankat pritet të aplikojnë ofertë kreditore të lehtësuara kryesisht për ndërmarrjet, duke u bazuar në kushtet dhe rregullat e ofruara. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që presin rritje të madhësisë së kredive për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Për NVM-të, bankat marginalisht liruan ngarkesat e tjera përveç normave të interesit dhe kërkesat për kolateral (indeks pozitiv i ulët prej 0.10 për të dy segmentet). Faktorë me kontribut pozitiv në kushtet dhe rregullat për kreditë e reja dhe me indeks prej 0.21 gjatë TM4 2020, pritet të jetë mbështetja e FKGK-së për NVM-të. Gjithashtu, qasja e favorshme në financim, rritja e presioneve të konkurrencës dhe qasja e favorshme e bankave amë në financim ishin faktorë tjerë që pritet të ndikojnë në lehtësim të kushteve dhe rregullave gjatë tremujorit të ardhshëm.

Kërkesa për kredi


Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rritje të dukshme krahasuar me TM2 2020, e që rezultoi të jetë në një nivel më të lartë se sa pritjet e bankave në anketën e kaluar (TM2 2020) (grafiku 3). Konkretisht, kërkesa për kredi nga NVM-të u rrit me një indeks pozitiv prej 0.32, përderisa kërkesa nga ndërmarrjet e mëdha me një indeks pozitiv marginal

prej 0.07. Rritja e kërkesës për kredi gjatë kësaj periudhe i'u atribua riaktivizimit të disa veprimtarive ekonomike të sektorëve më të prekur të ndërmarrjeve, si rezultat i lehtësimit të masave të ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së Covid-19, dhe nevojave të shtuara për likuiditet.

Sipas anketës, rritja e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet në masë më të madhe u ndikua nga rritja e theksuar e kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues (indeks pozitiv prej 0.40) dhe deri në një masë, nga rritja e kërkesave për financimin e blerjes/bashkimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve dhe kërkesës për ristrukturim të borxheve (indeks pozitiv prej 0.19 dhe 0.11, respektivisht). Në ndërkohë, cilësia e aplikacioneve të pranuar mbeti pothuajse e pandryshuar, me ndryshime marginale pozitive për të dy kategoritë e ndërmarrjeve.

Sipas anketës, raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve vazhdoi të karakterizohet me indeks pozitiv prej 0.14 (nivel i përafërt me anketën paraprake me indeks pozitiv prej 0.10), që nënkupton rritje deri në një masë të kredive jo-performuese të ndërmarrjeve.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Përgjatë tremujorit të ardhshëm, bankat nuk presin ndryshim të rëndësishëm në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet, duke u mbështetur në pritjet për rivendosjen e masave të ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 me shfaqjen potenciale të valës së dytë të infektiveve në vend. Këto pritje u pasqyruan në parashikimet e bankave për kërkesën për kredi gjatë TM4 2020. Rrjedhimisht, kërkesa pritet që kryesisht të mos ketë ndryshime të rëndësishme për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Përkundër, pritjeve të bankave për kërkesë të pandryshuar, ato listuan faktorë që ndikuan në kërkesën për kredi. Faktor pozitiv në kërkesën për kredi pritet të jetë nevoja për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, përderisa kërkesa për ristrukturimin e borxhit pritet të ndikojë negativisht kërkesën për kredi nga ndërmarrjet, duke marrë parasysh që afati për aplikim për ristrukturim të borxhit si pasojë e Covid-19 përfundoi në TM3 2020. Gjithashtu, bankat presin që raporti i kredive jo-performuese të përkeqësohet edhe më tutje në TM4 2020, me një indeks pozitiv prej 0.25.

Përkundër aktivitetit ekonomik deri në një masë të kufizuar gjatë TM4 2020, bankat presin përmirësime deri në një masë në cilësinë e aplikacioneve për kredi nga ndërmarrjet. Andaj, pritjet për TM4 janë të ngjashme, me një indeks të ulët pozitiv prej 0.13 për NVM-të dhe indeks pozitiv prej 0.10 për ndërmarrjet e mëdha.


Kreditë ndaj ekonomive familjare

Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 përgjithësisht u lehtësuan në krahasim me tremujorin paraprak me një indeks pozitiv prej 0.21 për kreditë për blerjen e shtëpive dhe indeks pozitiv prej 0.36 për kreditë konsumuese. Gjithashtu, pritjet për tremujorin e tretë të deklaruar nga bankat në anketën e kaluar sugjeronin për lehtësim të standardeve kreditore të aplikuara mirëpo në një nivel më të ulët (grafiku 4). Njëkohësisht, bankat deklaruan të kenë rritur dukshëm normën e aprovimit të kredive për ekonomitë familjare në një masë më të madhe për kreditë konsumuese (indeks pozitiv prej 0.57) se sa për kredi për blerjen e shtëpive (indeks pozitiv prej 0.46).

Masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për pezullimin apo zvogëlimin e aktivitetit në sektor të caktuar ekonomik me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë u lehtësuan dukshëm gjatë tremujorit të tretë, gjë që kontribuoi pozitivisht në ndryshim të standardeve kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare me një indeks pozitiv prej 0.34. Faktorë tjerë që kishin kontribut pozitiv ishin rritja e presioneve të konkurrencës, qasja e favorshme në financim (depozitat e tregut të brendshëm), si dhe në një masë më të ulët, perspektiva e mirë e bankave amë.

Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan




Në tremujorin e katërt 2020, kryesisht duke u bazuar në masat mbështetëse të ndërmarra nga institucionet e vendit, e njëkohësisht edhe mundësia për rivendosjen e masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19 si pasojë e valës së dytë të infektiveve, bankat presin standarde kreditore të lehtësuara për ekonomitë familjare mirëpo me një indeks pozitiv më të ulët prej 0.18. Standardet kreditore pritet të lehtësohen në një nivel më të lartë për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive, me indeks pozitiv prej 0.15 dhe 0.12, respektivisht. Standardet kreditore pritet të ndikohen pozitivisht nga rritja e presioneve të konkurrencës, si dhe përmirësimi deri në një masë të perspektivës së tregut si në vend ashtu edhe jashtë tij. Përkundër që nuk është reflektuar në pritjet e përgjithshme për standardet kreditore, bankat kanë deklaruar se deri në një masë përkeqësimi i cilësisë së portfolios kreditore si në vend ashtu edhe jashtë tij, si dhe rreziku nga kolaterali i kërkuar pritet të kontribuojnë negativisht në standardet kreditore gjatë TM4 2020. Njëkohësisht, bankat presin rritje deri në një masë të nivelit të aprovimit të kredive, e që është në nivel dukshëm më të ulët krahasuar me vlerat aktuale në TM3 2020. Niveli i aprovimit të kredive pritet të rritet në një masë më të madhe për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive, indeks pozitiv prej 0.18 dhe 0.15 respektivisht.

Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u lehtësuan në tremujorin e tretë të vitit 2020, edhe pse në nivel të ulët. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave ishte më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Kryesisht, kushtet dhe rregullat u lehtësuan përmes uljes së normës së interesit (indeks pozitiv prej 0.20 për kreditë për blerjen e shtëpive dhe 0.10 për kreditë konsumuese), uljes së ngarkesave tjera përveç interesit (indeks pozitiv prej 0.17 për të dy llojet e kredive), si dhe uljes së kërkesës për kolateral (indeks i ulët pozitiv prej 0.16 për kreditë për blerjen e shtëpive dhe 0.07 për kreditë konsumuese). Gjithashtu, bankat rritën shumën e kredive me një indeks pozitiv prej 0.16 (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

* Vlera e pritur

Faktorët që kontribuuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara janë kryesisht rritja e presioneve të konkurrencës, financimi stabil i sektorit nga burimet e brendshme, lehtësimi i masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, si dhe perspektiva e mirë në tregun e patundshmërive.

Për tremujorin e katërt të vitit 2020, bankat deklaruan se presin që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të lehtësohen. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Kryesisht, të gjitha kushtet dhe rregullat për kreditë për blerjen e shtëpive pritet të lehtësohen deri në një masë. Pritjet për rritjen e shumës së kredisë kanë një indeks pozitiv prej 0.21, pasuar nga zbritja e normës së interesit dhe ngarkesave tjera dhe zgjatja e maturitetit me indeks pozitiv prej 0.15. Përderisa, për kreditë konsumuese, kushtet që pritet të lehtësohen janë ulja e ngarkesave tjera përveç interesit dhe ulja e kërkesave për kolateral me një indeks pozitiv të ulët prej 0.12. Këto pritje u bazuan në perspektivën e mirë të tregut të patundshmërive, qasje të favorshme të bankave amë në financim, rritjen e presioneve të konkurrencës, financimin stabil të sektorit, si dhe perspektivën më të mirë të bankave amë.

Kërkesa për kredi


Lehtësimi i masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, dërgesat dhe vizitat e diasporës në vend, si dhe ringjallja deri në një masë e aktivitetit ekonomik u reflektuan në rritje të theksuar të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare në tremujorin e tretë të vitit 2020. Bankat raportuan për rritje të ngjashme të kërkesës për kredi për të dy kategoritë e kredive të ekonomive familjare. Tetë nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi, me indeks pozitiv prej 0.69. Kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive kishte një indeks pozitiv prej 0.58, ndërsa për kreditë konsumuese kishte indeks pozitiv prej 0.59. Nëse krahasojmë rezultatet aktuale të kërkesës për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për

të njëjtën periudhë, niveli i rritjes së kërkesës është shumë herë më i lartë, ku për kreditë për blerjen e shtëpive pritjet ishin për kërkesë të pandryshuar (grafiku 6).

Kjo rritje u ndikua pozitivisht nga të gjithë faktorët e listuar në anketë, mirëpo faktori me ndikimin më të lartë ishte nevoja për ristrukturim të borxhit me indeks pozitiv prej 0.44, pasuar nga perspektiva e favorshme e tregut të patundshmërive dhe nevoja për financim të konsumit me indeks pozitiv prej 0.37 dhe 0.34, respektivisht. Bankat po ashtu deklaruan që në një nivel më të ulët, në rritje të kërkesës për kredi kontribuoi rritja e konfidencës së konsumatorit (indeks pozitiv prej 0.22). Cilësia e aplikacioneve të pranura për kredi nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm, dhe u karakterizua me një indeks pozitiv, mirëpo marginal prej 0.07 për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare.

Bankat deklaruan përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me rezultatet e anketës së kaluar. Ndryshimet në cilësinë e portfolios u bazuan në përgjigjet për raportin e kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare me indeks pozitiv prej 0.21 kundrejt indeksit pozitiv prej 0.34 sa deklaruan bankat në anketën e kaluar (TM2 2020).

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Në tremujorin e katërt të vitit 2020, bankat presin rritje të kërkesës për kredi deri në një masë për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare, mirëpo në nivel dukshëm më të ulët se sa në tremujorin aktual. Bankat deklaruan se presin rritje të kërkesës për kredi për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.20 dhe kërkesë për kredi konsumuese me indeks pozitiv prej 0.18. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat i'a atribuuan këto pritje tregut të favorshëm të patundshmërive, si dhe në masë të vogël, rritjes së kërkesës për ristrukturim të borxhit.

Bankat presin rritje të rrezikut kreditor në tremujorin e katërt të vitit 2020, bazuar në pritjet për rritje të raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive të ekonomive familjare me një indeks pozitiv prej 0.26.

Njëkohësisht, bankat deklaruan se presin përmirësim në masë të vogël të cilësisë së aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare, veçanërisht për kreditë për blerjen e shtëpive me një indeks pozitiv prej 0.13.

Financimi


Bankat raportuan rritje të qasjes në financim gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020. Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë, financimi vazhdoi të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve.

Për dallim nga anketa e kaluar, rezultatet tregojnë që financimi i bankave u rrit në një nivel më të lartë nga depozitat e ndërmarrjeve me një indeks prej 0.29. Njëkohësisht, edhe depozitat nga ekonomitë familjare kontribuan në financimin e sektorit bankar me një indeks prej 0.24. Burimet

tjera të financimit nuk shënuan ndryshime të rëndësishme (grafiku 7). Dy nga bankat e anketuara deklaruan rritje të financimit deri në një masë nga banka amë, mirëpo për shkak peshës të vogël, indeksi për këtë komponentë rezultoi marginal. Sipas maturitetit, depozitat afatshkurtra ishin burimi kryesor për financim gjatë këtij tremujori, me një indeks të lartë prej 0.55.

Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin që rritja e qasjes në financim të vazhdojë. Financimi përmes depozitave të ndërmarrjeve pritet të rritet në një nivel më të lartë krahas depozitave të ekonomive familjare, indeks pozitiv prej 0.33 dhe 0.21, respektivisht. Në tremujorin e katërt, dy banka me rëndësi sistemike presin mbështetje në financim të aktivitetit bankar edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. Përderisa, një bankë me peshë të ulët në kreditimin e sektorit deklaroi se pret mbështetje në financimin nga banka amë. Sipas maturitetit, në tremujorin e ardhshëm pritet të vazhdojë rritja më e lartë e financimit afatshkurtër krahas atij afatgjatë, saktësisht indeks pozitiv prej 0.25 dhe 0.21, respektivisht (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Rezultatet e pyetjeve të fokusuara: Ndikimet e Covid-19 në sektorin bankar

Pyetëtori i anketës për tremujorin e tretë 2020 është plotësuar me katër pyetje shtesë, me qëllim të vlerësimit të ndikimit të krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 në ofertën dhe kërkesën e përgjithshme kreditore. Gjithashtu, pyetjet adresojnë edhe perceptimin e bankave për rreziqet që janë nxitur nga kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19, dinamikat në rritjen e kreditimit, si dhe efektivitetin e masave të ndërmarra nga institucionet e vendit në adresimin e rreziqeve të rritura në këtë periudhë.

Sa i përket rreziqeve në rritje për sektorin bankar gjatë kësaj periudhe, bankat deklaruan se rreziku kreditor vazhdon të mbetet rreziku kryesor në rritje, e veçanërisht gjatë vitit të ardhshëm. Bankat theksuan ndikimin pozitiv të masave të ndërmarra për shtyrjen e pagesës së kësteve të kredisë. Megjithatë, tutje bankat deklaruan se ndikimi i këtyre masave eventualisht do të zbehet dhe se pritet të ketë përkeqësim të portfolios kreditore në vitin e ardhshëm 2021, kryesisht duke u mbështetur në indikacionet për dobësim të aftësive paguese të klientëve bankar si pasojë e dinamikave në ambientin e përgjithshëm makroekonomik.

Në pyetjen shtesë mbi ndikimin e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike në ofertën për kredi, bankat deklaruan se nuk presin ndikim të madh apo efektivitet nga Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike, për shkak të vonesave në aprovim në Kuvendin e Kosovës, e për pasojë, edhe vonesës në implementim të kësaj pako pas aprovimit. Gjithashtu, bankat deklaruan se pako si e tillë nuk është e mjaftueshme në adresimin e problemeve me të cilat përballlet sektori privat, si dhe shprehën dyshime në implementimin e duhur të kësaj pakoje si pasojë e proceseve politike në periudhën në vijim (zgjedhje të reja/qeveri e re). Rrjedhimisht, kjo masë nuk pritet të ketë ndikim në rritjen e ofertës kreditore.

Përderisa, një nga bankat sistemike theksoi se ndër masat efektive që ndikuan pozitivisht në ofertën kreditore ishin masat e ndërmarra nga BQK si shtyrja e pagesës së kësteve kreditore, dhe se në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes, mirëpresin rritjen e mbulesës së garancisë për kredi deri në 80 përqind nga FKGK dhe subvencionet në normën e interesit dhe tarifa.

Bazuar në dinamikat e kreditimit gjatë vitit 2020, bankat u pyetën për një parashikim të rritjes së kreditimit deri në fund të vitit përkatës. Në këtë pyetje, bankat përgjithësisht presin rritje të kreditimit mirëpo në nivel më të ulët në krahasim me vitet paraprake prej rreth 7 përqind për vitin 2020.

Sa i përket pyetjes mbi pritjet e bankave për kalimin e kredive të ristrukturuara në kredi jo-performuese, bankat theksuan që kryesisht nuk presin që kreditë e ristrukturuara të kalojnë në kredi jo-performuese në vitin 2020. Sidoqoftë, ato shtuan se efekti i krizës ekonomike në cilësinë e portofolios kreditore presin të shfaqet pas tremujorit të parë të viti 2021, kur edhe skadon masa e ristrukturimit për pothuajse gjysmën e kredive të ristrukturara dhe kredimarrësit fillojnë të paguajnë këste të rregullta të kredive. Një nga bankat me rëndësi sistemike, rrjedhimisht me peshë të madhe në sektor, ka deklaruar se pret që rreth 20 përqind e kredive të ristrukturuara të përkthehen në kredi jo-performuese. Për më tepër, bankat deklaruan se edhe përgjatë procesit të kërkesave për ristrukturim është bërë rivlerësimi i rrezikut dhe është ndarë provizion përkitazi me rrezikun e klientëve.

Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK ka vazhduar me anketimin e institucioneve financiare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit të realizuar në tetor 2020, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e tretë të vitit 2020, pyetësori adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e katërt dhe për vitin 2020 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivitetit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si bazë e rëndësishme në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomik: konsumatorëve, ndërmarrjeve, bankave komerciale, etj. Banka Qendrore e Kosovës, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale dhe në të ardhmen pritet të zgjerohet edhe me agjentë të tjerë ekonomik.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht pritjet për tërë vitin aktual, shoqëruar edhe me vlerësimet për tremujorin paraprak si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale. Analiza e pritjeve të inflacionit pritet të jetë pjesë e raporteve të rregullta të BQK-së..

Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në tetor të vitit 2020, bankat kanë vlerësuar nivel më të ulët të inflacionit krahasuar me vitin e kaluar. Për tremujorin e katërt të vitit 2020, bankat presin një ngritje të lehtë të shkallës së inflacionit krahasuar me tremujorin paraprak. Bankat kanë vlerësuar se inflacioni do të jetë 0.7 përqind në vitin 2020, nga 2.7 përqind sa ishte në vitin 2019. Për TM4 2020, bankat presin një shkallë mesatare të inflacionit prej 0.5 përqind, nga 0.2 përqind që e kanë vlerësuar

për tremujorin paraprak (tabela 1). Anketa e realizuar në korrik përfshinë edhe efektet potenciale që presin bankat pas përballjes me gjendjen e re të paprecedent të shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Tabela 1. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	2020	TM3 2020	TM4 2020
1	0.8%	0.3%	0.1%
2	0.5%	-0.5%	0.4%
3	0.2%	-0.1%	0.3%
4	-0.6%	-0.4%	-0.6%
5	0.7%	-0.5%	-0.1%
6	0.5%	0.5%	0.5%
7	2.3%	2.1%	2.2%
8	1.3%	0.5%	1.0%
9	0.3%	-0.4%	0.3%
Mesatarja	0.7%	0.2%	0.5%

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.


Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) deri në dhjetor të vitit 2020 sugjerojnë se inflacioni ishte rreth 0.2 përqind, ndërsa vetëm në TM3 2020, të dhënat aktuale për këtë tremujor sugjerojnë se është shënuar deflacion prej 0.4 përqind. Pra, pritjet e bankave kanë qenë se niveli i inflacionit do të jetë paksa më i lartë krahasuar me të dhënat aktuale. Shumica e bankave të anketuara presin që inflacioni do të sillet ndërmjet intervalit 0 dhe 1 përqind; dy banka presin që inflacioni do të jetë më i lartë se 1 përqind dhe dy banka tjera presin që të kemi deflacion në tremujorin e katërt të vitit 2020.

Siç ilustron figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë një pasiguri relativisht të ulët në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur. Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë cituar disa faktorë të mundshëm për nivelin e inflacionit:

- ✓ Për shkak të rritjes së rasteve të infektuarve me korona virus në të gjithë botën gjatë tremujorit të fundit të vitit 2020, shumica e bankave kanë deklaruar se do të ketë rënie të aktivitetit ekonomik dhe rrjedhimisht kërkesa e dobësuar nuk do të bëjë presion në rritjen e çmimeve të konsumit. Në anën tjetër, disa prej bankave kanë deklaruar se për shkak të shkëputjes së zinxhirit të furnizimit, çmimet mund të rriten;
- ✓ Çmimet e energjisë parashihet të mbesin të ulëta për një kohë më të gjatë;
- ✓ Prodhim i ulët në Kosovë dhe varësia e lartë nga importet;
- ✓ Zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Pritjet e bankave për vitin 2020 janë në përputhje me trendin më të ulët të inflacionit krahasuar me vitin paraprak. Sidoqoftë, duke pasur parasysh deflacionin e muajve të fundit, pritjet e bankave kanë rezultuar të jenë të larta deri në një masë.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM4 2020 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulimet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org